



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-89
Prishtinë, më 26 janar 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 JANAR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviç dhe Mufera Shinik, anëtarë të Kryesisë.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga NDI: Rinor Beka,
Nga OSBE: Floriana Shala.
Nga ICO: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe këto pika shtesë:

1. Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, z. Nexhat Daci, për ndërrim të veturës,
2. Kërkesa e deputetit Enis Kervan, për sigurimin përkthyesit gjatë udhëtimit zyrtar në Zvicër.

Kryesia miratoi propozimin e kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 janar 2010,
2. Propozimi i pikave shtesë për seancën plenare të 28 janarit 2010,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 janar 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 janar 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i pikave shtesë për seancën plenare të 28 janarit 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për pikat shtesë të propozuara, vendosi që seancës plenare të 28 janarit 2010, t'ia propozojë edhe këto dy pikat shtesë:

1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen e mjeteve financiare për RTK-në,
2. Propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me mandatin dhe Rregulloren e Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit dhe nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që të shqyrtojnë Rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me fushëveprimin dhe Rregulloren e brendshme të këtij komisioni dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve Hafize Hajdini dhe Etem Arifi, nga Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës, për emërimin me rotacion në Kryesinë e Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet sekretari i Kuvendit që në bazë të Marrëveshjes së Grupit të deputetëve nga radha e komuniteteve jo shqiptarë dhe jo serbë, për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë me rotacion, ta përgatisë dhe Kryesisë t'ia dërgojë një informatë.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për lejimin e kohës shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për Shërbimin Civil dhe të Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohej kërkesa e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për afat shtesë edhe 15 ditë për shqyrtimin e Projektligjit për Shërbimin Civil dhe të Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Muzeut të Kosovës për mbrojtjen, ruajtjen dhe prezantimin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Muzeu i Kosovës që në lidhje me mbrojtjen, ruajtjen dhe prezantimin e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës të veprojë në bazë të dispozitave të Ligjit për trashëgiminë kulturore.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për lejimin e kompensimit të punës shtesë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në shumën prej 50 euro për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

3.6 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s për pjesëmarrje të një delegacioni parlamentar të Kuvendit në seminarin në Yerevan të Armenisë

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Sllobodan Petroviq, për pjesëmarrje në seminarin “Zhvillimet Regjionale në Kaukazin Jugor, sfidat, mundësitë dhe perspektivat”, në Yerevan të Armenisë, prej 11 deri më 13 mars 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon OSBE-ja, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për lejimin e udhëtimit në Zvicër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në përbërje: Sanije Aliaj, Bojan Stojanoviç, Kosara Nikoliq, Enis Kervan, Mufëra Shinik, Sadik Idriz, Numan Baliq, Xhevdet Neziraj, Etem Arifi, Hafize Hajdini, Zylfi Merxha dhe Mursel Halili, si dhe zyrtarët : Natasha Prica, Xheladin Hoxha dhe Mikel Mirakaj, në Zvicër, prej 31 janar deri më 6 shkurt 2010.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, Nexhat Daci, për ndërrim të veturës

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të përgatisë dhe Kryesisë t'ia paraqesë një informatë për numrin, destinimin dhe gjendjen teknike të automjeteve të Kuvendit.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit, Enis Kervan, për sigurimin e përkthyesit gjatë udhëtimit zyrtar në Zvicër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Të shikohet mundësia e zëvendësimit të ndonjërit nga zyrtarët e administratës, që janë caktuar nga Komisioni për udhëtim zyrtar në Zvicër, me një përkthyes.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**